



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
FIER

Nr. 12246/2 Prot.

Fier më 26.12.2024

V E N D I M

Nr. 155 Dt. 23.12.2024

**“Për miratimin e dhënies pa kundërshtëpërblim të pasurisë nr. 3/257 zk. 8534 me sipërfaqe 610 m<sup>2</sup> “bodrum” ndodhur në lagjen “Apolonia”, pronë e Bashkisë Fier shoqatës “Bilardo Apolonia Fier”, me qëllim përdorimin dhe shfrytëzimin vetëm për veprimtari dhe aktivitete sportive si dhe qendër ditore për moshën e tretë”**

Bazuar në nenin 54/e/1 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, nenin 901 e vijues të K.Civil, nenin 15,16 të statutit të shoqërisë aksionare Klubit Shumësportësh “Apolonia” Sh.A., Këshilli i Bashkisë;

V E N D O S I

1. Miratimin e draft – kontratës së propozuar për tu lidhur midis shoqatës “Bilardo Apolonia Fier” dhe Klubit Shumësportësh “Apolonia” Fier sh.a., për pasurinë e llojit “bodrum” me nr. pasurie 3/257-B1 zk. 8534 me sipërfaqe 610 m<sup>2</sup> “bodrum” ndodhur në lagjen “Apolonia”, pronë e Bashkisë Fier. (kontrata bashkëlidhur)
2. Pasuria do të jepet në përdorim pa kundërshtëpërblim dhe do të shfrytëzohet vetëm për veprimtari dhe aktivitete sportive si dhe qendër ditore për moshën e tretë.
3. Afati i dhënies në përdorim do të jetë në përputhje me destinacionin e veprimtarisë dhe aktivitetit për një afat 5 vjeçar.
4. Ngarkohet Klubi Shumësportësh “Apolonia” Sh.a. dhe ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore të përcaktuara nga ligji
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Antoneta ÇUNAJ

